

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikaplan® WP 1100-20 HL

MEMBRANË HIDROIZOLIMI BAZAMENTESH DHE TUNELESH



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikaplan® WP 1100-20 HL është membranë hidroizoluese fleksibël me shtresë sinjalizuese dhe bazë polivinilkloridi (PVC-P) të cilësisë së lartë.

PËRDORIMET

Hidroizolim bazamentesh dhe bodrumesh kundër hyrjes së ujit.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Rezistencë e lartë ndaj vjetërimit
- Me bazë material të virgjër për cilësi konsistente
- Pa plastifikues DEHP (DOP)
- Me shtresë sinjalizuese që tregon dëmtimet
- Fleksibilitet, rezistencë ndaj tërheqjes dhe zgjatim multi-aksial të optimizuara
- Sjellje elastike e materialit
- Rezistencë e lartë ndaj ndikimeve mekanike
- Fleksibël në temperatura të ulëta
- E përshtatshme për kontakt me ujin e butë acid dhe mjediset alkaline
- Rezistencë ndaj depërtimit të rrënjëve dhe mikroorganizmave
- Punueshmëri e optimizuar, mund të saldohet me nxehtësi
- Mund të instalohet mbi nënshtresa të lagështa por edhe të lagura
- Qëndrueshmëri e përkohshme ndaj rrezatimit UV për instalimin
- Vetëshuhet në rast zjarri

MIRATIME / STANDARDE

- Barrierë polimerike gjeosintetike për përdorim në tunele dhe struktura nëntokë. Barrierë për lëngjet.' sipas EN 13491, certifikuar nga organi i kontrollit të njoftuar të prodhimit në fabrikë 1213, certifikatë konformiteti nga kontrolli i prodhimit në fabrikë 1213-CPR-028 dhe mbart markën CE.
- 'Fleta fleksibël hidroizolimi - Fleta plastike dhe gome kundër lagështisë përfshirë fleta plastike dhe gome për mbrojtjen e dyshemesë' sipas EN 13967, certifikuar nga organi i kontrollit të njoftuar të prodhimit në fabrikë 1213, certifikatë konformiteti nga kontrolli i prodhimit në fabrikë 1213-CPD-029 dhe mbart markën CE.
- Certifikatë për siguri mjedisi BBodSchV / M Geok E

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Ambalazhi	Përmasat e rulonit	2.20 m (gjerësi) × gjatësi ruloni 20 m ose individualisht siç specifikohet
Paraqitja / Ngjyra	Sipërfaqja Ngjyra	e lëmuar shtresa sinjalizuese: e verdhë shtresa e poshtme: gri e errët
Jetëgjatësia	5 vjet nga data e prodhimit nëse ruhet në ambalazhin original, të padëmtuar dhe të mbyllur	
Kushtet e magazinimit	Rulonat duhet të ruhen në ambalazhin e tyre original, në pozicion horizontal dhe në kushte të freskëta dhe të thata. Duhet të mbrohen nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor, shiu, dëbora dhe akulli, etj. Mos vendosni paletat e rulonave njëra mbi tjetrën gjatë transportit apo magazinimit.	
Trashësia efektive	2.00 (-5 / +10 %) mm përfshirë shtresën sinjalizuese	(EN 1849-2)
Masa për njësi sipërfaqeje	2.56 (-5 / +10 %) kg/m ²	(EN 1849-2)

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj tërheqjes	17.0 (± 2.0) N/mm ² (drejtim gjatësor) 16.0 (± 2.0) N/mm ² (drejtim tërthor)	(ISO 527)(EN 12311-2)
Zgjatimi deri në thyerje	≥ 300 % (drejtim gjatësor/ tërthor)	(ISO 527)
Moduli i elasticitetit në tërheqje	≤ 20 N/mm ² (drejtim gjatësor/tërthor) (midis 1 % dhe 2 % zgjatim, v = 5mm/min)	(ISO 527)
Forca e shpërthimit	≥ 80 % (D=1.0 m)	(EN 14151)
Rezistenca ndaj shpimit statik	2.35 (± 0.25) kN	(EN ISO 12236)
Rezistenca ndaj goditjes	I papërshkueshëm nga uji në rënie nga lartësia 750 mm (peshë rënieje 500 g, Metoda A)	(EN 12691)
Rezistenca afatgjatë ndaj ngjeshjes	E papërshkueshme nga uji në 7.0 N/mm ² (50 orë) (ngjashëm me SIA V280/14)	
Palosja në temperatura të ulëta	Pa plasaritje në - 20 °C	(EN 495-5)
Ndryshimi i përmasave në ngrohje	Ndryshim përmasash < 2.0% (gjatësor/tërthor)	(EN 1107-2) (+80°C/6orë)
Rezistenca ndaj oksidimit	Ndryshim në zgjatim ≤ 10 % Ndryshim në rezistencën ndaj tërheqjes ≤ 10 %	(EN 14575) (120 ditë/80°C)
Reagimi pas depozitimit në ujë të ngrohtë	Ndryshim i rezistencës ndaj tërheqjes < 20 % (gjatësor/tërthor) Ndryshim i zgjatimit < 20 % (gjatësor/tërthor) Ndryshim i masës < 4 % Ndryshim i masës < 10 %	(SIA V280/13 dhe OEBV) (50°C/8 muaj) (EN 14415) (70°C/360 ditë)

Rezistenca kimike	Tretësirë e ngopur gëlqereje (Lëng testimi 2)		
	Reduktim i rezistencës ndaj tërheqjes dhe zgjatimit	≤ 20 %	(EN 14415) (23°C/90ditë)
	5-6 % acid sulfurik (Lëng testimi 3)		
	Reduktim i rezistencës ndaj tërheqjes dhe zgjatimit	≤ 20 %	(EN 1847) (23°C/90ditë)
	Fleksibiliteti në temperatura të ulëta	Pa plasaritje në -20 °C	
	<hr/>		
Rezistenca mikrobiologjike	Ndryshim në rezistencën ndaj tërheqjes	≤ 15 %	(EN 12225) (16 javë)
	Ndryshim në zgjatim	≤ 15 %	
<hr/>			
Reagimi ndaj zjarrit	Kategoria E		(EN 13501-1) (EN ISO 11925-2)
<hr/>			
Reagimi pas saldimi të mbivendosjeve	Rezistenca e tegelit të salduar nga prerja	Çarja ndodh jashtë tegelit	(EN 12317-2)
	Rezistenca e tegelit të salduar nga shkëputja	≥ 6.0 N/mm	(EN 12316-2)
<hr/>			
Temperatura e funksionimit	-10 °C / +35 °C max.		
<hr/>			
Temperatura maksimale e lëngjeve të mjedisit	+35 °C		

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit	Produkte ndihmëse: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sikaplan® WP Disc ▪ Sikaplan® W Felt PP ▪ Sikaplan® W Tundrain ▪ Sikaplan® WP Protection Sheets ▪ Sika Waterbar® WP për formim kompartmentesh, hidroizolim fugash betoni dhe për fiksime/përfundime tek betoni ▪ Sikaplan® WP Tape
-----------------------------	--

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Temperatura e mjedisit	+5 °C min.
-------------------------------	------------

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS

Betonime në vend: E pastër, e qëndrueshme dhe e thatë, homogjene, pa vaj dhe graso, pluhur dhe grimca të lira ose të shkrifëta.

Beton me spërkatje: Profili i sipërfaqes që do të spërkatet me beton nuk duhet të kalojë raportin e gjatësisë me thellësinë 5:1 dhe rrezja min. duhet të jetë 20 cm. Sipërfaqja që do të spërkatet me beton nuk duhet të ketë agregate të thyera. Çdo rrjedhje duhet të izolohet me llaç hidroizolues Sika® ose të drenazohet me sistemin Sika® FlexoDrain. Kudo që nevojitet të arrihet profili/sipërfaqja e dëshiruar, aplikoni një shtresë të hollë betoni të spërkatur mbi sipërfaqen e spërkatjes me trashësi min. 3-5 cm dhe diametri i agregateve nuk duhet të kalojë 8 mm. Çeliku (trarët, rrjeta përforcuese, ankorazhet, etj.) duhet të mbulohet gjithashtu me beton të spërkatur në trashësi

min. 4 cm. Sipërfaqja ku do të spërkatet betoni duhet të jetë e pastër (pa gurë të lirë, gozhdë, tela, etj.). Përpara instalimit të membranës Sikaplan® WP 1100-20 HL, duhet të instalohet gjithashtu një gjeotekstil polipropileni (≥ 500 g/m²) ose një shtresë kompatibël drenazhimi.

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Membrana Sikaplan® WP 1100-20 HL vendoset me shtrim të lirë dhe mbërthehet mekanikisht, ose me shtrim të lirë dhe me balast në përputhje me Sika Method Statement për instalimet e membranave hidroizoluese (disponohen sipas kërkesës). Të gjitha mbivendosjet duhet të jenë të thata dhe pa kontaminues. Për sipërfaqet e kontaminuara, ndiqni udhëzimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes, etj. tek Sika Method Statement. Të gjitha mbivendosjet e membranës duhet të saldohen me pistoleta manuale saldimi dhe rula për ngjeshje ose makineri automatike

saldimi, me temperatura saldimi individualisht të adaptueshme dhe elektronikisht të kontrolluara (si manual: Leister Triac PID / automatik: Leister Twinny S / gjysëm-automatik: Leister Triac Drive). Parametrat e saldimit, si shpejtësia dhe temperatura duhet të përcaktohen me prova në terren, përpara nisjes së punimeve të saldimit. Ekzekutimi i fugave në formë T-je kërkon përgatitje të veçantë të zonës së saldimit. Në zonën e saldimit mbivendosjet duhen prerë pjerrët me kujdes.

KUFIZIME

Punimet e instalimit duhet të kryhen vetëm nga kontraktorë të trajnuar nga Sika®, me përvojë në hidroizolimim e tuneleve dhe strukturave nëntokë. Duhet të merren masa të veçanta parandaluese për instalime në kushte të lagështa, në temperatura nën +5°C dhe kur lagështia relative është më e lartë se 80%. Duhet të provohet efikasiteti i këtyre masave. Duhet të sigurohet gjithmonë ajrosje e freskët, sidomos gjatë punimeve (saldimeve) në dhoma të mbyllura dhe në përputhje me rregulloret lokale përkatëse. Membrana nuk ka rezistencë ndaj kontaktit të përhershëm me materiale si bitumi dhe disa lloje plastikash të ndryshme nga PVC. Për përdorim mbi ose pranë këtyre materialeve, kërkohet një shtresë ndarëse prej gjeotekstil polipropileni ($\geq 150 \text{ g/m}^2$). Membrana nuk ka rezistencë ndaj rrezatimit UV dhe nuk mund të instalohet mbi struktura me ekspozim të përhershëm ndaj rrezatimit UV dhe ndikimeve të motit.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sikaplan® WP 1100-20 HL
Mars 2019, Botimi 03.01
020704110010000003

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

RREGULLORJA (EC) NO 1907/2006 - REACH

Ky produkt është një objekt siç përcaktohet në nenin 3 të rregullores (KE) Nr. 1907/2006 (REACH). Nuk përmban substanca që mund të çlirohen nga objekti nën kushte përdorimi normale ose të parashikuara arsyeshëm. Nuk nevojitet fleta e të dhënave të sigurisë në zbatim të nenit 31 të së njëjtës rregulloreje për të sjellë produktin në treg, transportuar apo përdorur atë. Për përdorim të sigurt, ndiqni udhëzimet që jepen në këtë fletë me të dhënat e produktit. Duke u bazuar në njohuritë tona aktuale, ky produkt nuk përmban SVHC (substances of very high concern / substanca me rrezikshmëri të lartë) siç renditen në Aneksin XIV të rregullores REACH apo në listën e substancave kandidatë të publikuar nga Agjencia Europiane e Kimikateve në përqëndrime më të mëdha se 0.2% (për peshë).

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

SikaplanWP1100-20HL-sq-AL-(03-2019)-3-1.pdf

